

**DORACAK**  
për plane  
për integritet të  
prokurimeve  
publike

Shkup, maj 2021



Kingdom of the Netherlands



**DORACAK**

**PËR PLANE PËR  
INTEGRITET TË  
PROKURIMEVE  
P U B L I K E**

Shkup, maj 2021

## **Edicioni elektronik:**

“Doracak për Plane për Integritet në Prokurimet Publike”

## **Publikues:**

Qendra për Komunikime Qytetare

## **Autor:**

Zoran Gavriloviq

## **Redaktor:**

Sabina Fakiq

## **Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:**

Eniena Aeti

## **Formulimi artistik-grafik:**

Brigada Design

CIP - Каталогизacija во публикација  
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

35.073.53(035)

GAVRILLOVIQ, Zoran

Doracak për plane për integritet të prokurimeve publike [Електронски извор] / [autor Zoran Gavriloviq ; përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Eniena Aeti]. - Shkup : Qendra për komunikime qytetare, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://www.ccc.org.mk>. - Начин на пристапување (URL): <https://www.opendata.mk>. - Превод на делото: Prirucnik za planove integriteta javnih nabavki. - Преvedено според:

Прирачник за планови за интегритет на јавните набавки. - Текст во PDF формат, содржи [52] стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 22.06.2021. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4709-97-8

а) Јавни набавки -- Прирачници

COBISS.MK-ID 54187781

Doracaku është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike të Përgjegjshme” me ndihmën financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën prej 1 tetor 2019 deri më 30 shtator 2021.

## PËRMBAJTJA

Hyrje, konceptet themelore dhe rëndësia e integritetit në luftën kundër korrupsionit.....	4
Prokurimi publik dhe mekanizmat për forcimin e integritetit.....	13
Përgatitja e planit për integritet.....	23
Metodologjia për përgatitjen e planit për integritet në prokurimin publik.....	29
Miratimi i vendimit për zhvillimin e një plani për integritet të prokurimit publik.....	32
Miratimi i vendimit për personin përgjegjës për hartimin e Planit për integritet të Prokurimit Publik.....	32
Miratimi i vendimit për zgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Punës për përgatitjen e një plani për integritet të prokurimit publik.....	33
Miratimi i Rregullores së Procedurës së Grupit të Punës për përgatitjen e Planit për integritet të Prokurimit Publik.....	35
Nënshkrimi i Deklaratës për Integritet të anëtarëve të Grupit të Punës për përgatitjen e planit për integritet të prokurimit publik.....	41
Zbatimi i analizës së rrezikut në nivelin e integritetit të prokurimeve publike.....	44
Raporti mbi përgatitjen e një plani për integritet të prokurimit publik.....	52
Miratimi i vendimit për zgjedhjen e një personi i cili do të monitorojë zbatimin e planit për integritet të prokurimit publik të autoritetit kontraktues.....	53
Përgatitja e një plani për monitorimin dhe vlerësimin, përkatësisht përgatitja e një raporti vjetor mbi integritetin e prokurimeve të zbatuara.....	53
Algoritmi i integritetit për përgatitjen e planit integriteti.....	56
Vendim për përgatitjen e planit për integritet në prokurimet publike.....	58
<b>Aneksi 1:</b> Tregues për monitorimin e rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike.....	60

## Hyrje, konceptet themelore dhe rëndësia e integritetit në luftën kundër korrupsionit

**P**lanet për integritet të prokurimit publik mund të jenë një mekanizëm efektiv për parandalimin e korrupsionit. Për këtë qëllim, së pari do të prezantojmë përkufizime të termave kryesorë, të cilët do të ndihmojnë lexuesin e doracakut të kuptojë dhe të jetë në gjendje të zbatojë informacionin dhe njohuritë e paraqitura në përgatitjen dhe/ose zbatimin e planeve për integritet të prokurimit publik.

Secili institucion ka legjitimitet, gjegjësisht korniza ligjore dhe funksion shoqëror për shkak të cilave është themeluar dhe nga i cili lind kompetenca e institucionit. Duke shkelur këto dy parime, ose njërin prej tyre, integriteti i institucionit cenohet duke shkatërruar organizimin e brendshëm, strukturën drejtuese dhe strukturën e kuadrove, komunikimin, komponentin tekniko-teknologjik dhe materialo-financiar, si dhe marrëdhëniet me rrethinën ku vendi qendror u përket klientëve, përdoruesve të shërbimeve të institucionit, gjegjësisht shtetit ose shoqërisë që themeloi institucionin.

Prandaj, do të paraqesim nocionin e qëndrueshmërisë së institucionit, masat e pajtueshmërisë së strukturave dhe funksionin e institucionit nga i cili varet integriteti i një institucioni. Qëndrueshmëria e institucionit ekziston aty ku ekziston pajtueshmëri mes:

- ▲ Interesave, nevojave dhe të drejtat e pjesëtarëve të institucionit me strukturën përkatëse - qëndrueshmëria e brendshme,
- ▲ Interesave, nevojave dhe të drejtat e klientëve të institucionit - qëndrueshmëria e jashtme,
- ▲ Interesave, nevojave dhe të drejtat e sistemit shoqëror - qëndrueshmëria sistematike.

Duke u mbështetur në këtë perceptim të institucioneve dhe funksioneve dhe qëndrueshmërisë së tyre, me termin korrupsion do të konsiderojmë “gjendjen e paqëndrueshmërisë së institucioneve në sektorin publik, privat dhe civil, rrjedhimisht në të cilën (të punësuarit dhe drejtuesit) dhe përreth (klientë - persona juridikë dhe individë) institucionet, si reagimi ndaj një situatë të tillë, ka devijime, si ato që shkojnë në drejtim të (ri) institucionalizimit - integritetit, ashtu edhe ato që manifestohen me abuzim të burimeve, të drejtave dhe ndikimit për interesat e një individi dhe/ose grupi”.

Reagimi ndaj gjendjes së paqëndrueshmërisë së një institucioni mund të jetë i dyfishtë. Nga njëra anë, në formë të korrupsionit dhe nga ana tjetër, mund të shfaqet në formë të nevojës për inovacione që synojnë forcimin e integritetit të institucionit.

Në lidhje me konceptin e planeve për integritet, gjegjësisht të kuptuarit e konceptit të rrezikut të paraqitjes së korrupsionit ose shkeljes së integritetit, është e rëndësishme të duhet se korrupsioni si devijim është një shkëmbim anomik i të mirave materiale, të drejtave dhe interesave mes dy ose më shumë njerëzve. “Shkëmbim anomik” është shkëmbimi i të mirave materiale, të drejtave dhe interesave mes dy ose më shumë palëve në të cilat janë shkelur normat etike, profesionale dhe ligjore.

Në çfarë mënyre do të njohim formën e korruptuar të institucionit? Institucioni me rrezik të korruptimit zakonisht karakterizohet nga mbizotërimi i sistemit informal të rregullimit të drejtave dhe detyrimeve

të anëtarëve të institucioneve mbi atë zyrtar; dominimi i parimeve të pushtetit, statusit dhe reputacionit mbi ekspertizën, procedurën, profesionalizmin; mungesa e kriterëve të vlerësimit të arritjeve; personalizimi i marrëdhënieve gjegjësisht pozicioni në institucionin e korruptuar varet nga vullneti i eprorit dhe qëndrimi i vartësit ndaj tij; shpërndarja oligarkike e qeverisë e pasqyruar në napoleonizëm, e cila thotë “pushtet nga lart, nënshtrim nga lart”; shfaqja e zinxhirëve të klikimeve dhe klaneve.

Në rrugën e krijimit të një institucioni në të cilin ka integritet, gjegjësisht që është i qëndrueshëm, ekzistojnë instrumente të “largimit” - anti-korrupsion, ose më saktë ekzistenca e akteve normative, mekanizmave institucionale, kapaciteteve dhe kompetencave të stafit që kontribuojnë drejtpërdrejt dhe/ose jo drejtpërdrejt në një mënyrë efektive dhe efikase për:

- ▲ Diagnostifikim të korrupsionit,
- ▲ Sanksionimi i korrupsionit,
- ▲ Parandalimi i korrupsionit si fenomen,
- ▲ Zhvillimi i normave (të reja) të mekanizmave, kapaciteteve dhe kompetencave për anti-korrupsion<sup>1</sup>

Do të paraqesim luftën kundër korrupsionit si një formulë<sup>2</sup>:

**ANTI-KORRUPSION = INTEGRITET+BURIME+NDIKIM/REZULTAT**

<sup>1</sup> Zoran Gavrilović dhe tjerë (2014), Lufta kundër korrupsionit në Serbi – Raporti alternativ, Byroja për Hulumtime Shoqërore, Beograd

<sup>2</sup> Zoran Gavrilović dhe tjerë (2014), Lufta kundër korrupsionit në Serbi – Raporti alternativ, Byroja për Hulumtime Shoqërore, Beograd



Lufta kundër korrupsionit e përcaktuar në këtë mënyrë ka një rrugë me katër faza dhe për secilën fazë kemi një vlerësim në bazë të së cilës mund të vlerësojmë vendndodhjen e një shoqërie apo qyteti.

Notimi	Gjendja nominuese në luftë kundër korrupsionit	Faza
0	Nuk ka luftë kundër korrupsionit, nuk ka luftëtarë kundër korrupsionit.	Të robëruar me korrupsionin
1-	Nuk ka një kornizë institucionale-ligjore, luftëtarët kundër korrupsionit diskriminohen në mënyrë që ta bëjnë të pamundur luftën kundër korrupsionit dhe/ose sjelljen e padëshirueshme shoqërore.	Tribunë
1	Nuk ka një kornizë institucionale-ligjore, luftëtarët kundër korrupsionit tolerohen, gjegjësisht dekurohen nëpërmjet mekanizmave të bashkëpunimit në korrupsion.	
1+	Nuk ka një kornizë institucionale-ligjore, luftëtarët kundër korrupsionit kanë një sistem të qartë integriteti, të organizuar dhe me ndikim në shoqëri në mënyrë të tillë që të mund të kryejnë veprimtari efektive që do të rrisin vetëdijen dhe interesin për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit, gjegjësisht iniciojnë përpunimin e çështjeve të korrupsionit.	
2-	Ekziston një kornizë institucionale-ligjore, por organet anti-korrupsion janë mjaft të pavarura dhe pa integritetin e duhur, lufta kundër korrupsionit varet kryesisht nga integriteti i individit, mjaft i efektshëm, nuk ka kushte të përshtatshme për punën e anti-korrupsionit.	Ligjore-institucionale
2	Ekziston një kornizë institucionale dhe ligjore, ka organe për luftë kundër korrupsionit që kanë ndër-tuar mekanizma integriteti, ndëshkimi për korrupsion është i sigurt për "korrupsion të vogël" dhe korrupsionin e zyrtarëve/zyrtarëve të rangut të ulët	
2+	Ekziston një kornizë ligjore-institucionale, organet për luftë kundër korrupsionit, vetëm ose në bashkëpunim me aktorë të tjerë anti-korrupsion, veprojnë në përputhje me detyrimet ligjore, duke rezultuar në zbulimin, ndjekjen penale, sanksionimin dhe mbështetjen e luftëtarëve kundër korrupsionit.	

3-	Komuniteti anti-korrupsion zbaton aktivitete që rezultojnë në zhvillimin e integritetit në nivelin e qytetarëve, institucioneve dhe profesioneve.	Socijalizuese
3	Qendra e luftës kundër korrupsionit bëhet shoqëria, e cila zbaton aktivitete që rezultojnë në parandalimin e korrupsionit duke krijuar një mjedis për luftën kundër korrupsionit, gjegjësisht integriteti – denoncimet.	
3+	Qendra e luftës kundër korrupsionit bëhet shoqëria, e cila zbaton aktivitete që rezultojnë në parandalimin e korrupsionit duke krijuar një mjedis për luftën kundër korrupsionit, gjegjësisht. integriteti – promovimi i vlerave etike.	
4	Nevoja për organe të posaçme për të luftuar korrupsionin pushon, integriteti i qytetarëve dhe institucioneve është në një nivel që garanton zbulimin, sanksionimin dhe dënimin efektiv të sjelljes korruptive.	Të lirë nga korrupsioni

Fjala “integritet” vjen nga shprehja latine integritas, që do të thotë “i paprekur, i drejtë dhe i besueshëm”. Sinonimet e integritetit janë ndershmeria, integriteti dhe pajtueshmëria, përgjegjësia profesionale, veprimi i motivuar nga respektimi i parimeve morale, veprimi për të parandaluar dhe zvogëluar rrezikun e ushtrimit të autoritetit publik në kundërshtim me qëllimin për të cilin është vendosur, dhe duke treguar sjellje joetike në përputhje me standardet etike dhe ligjin.

Për qëllimet e këtij doracaku, gjegjësisht për një kuptim më të mirë të konceptit të planeve për integritet, me integritet nënkuptojmë “respektim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të ligjit, procedurës, gjegjësisht standardeve etike profesionale dhe rregullave të profesionit, me çfarë arrihet siguria dhe parashikueshmëri në sjellje në lidhje me kryerjen e funksioneve dhe kompetencave me anë të forcimit të:

- ▲ Integriteti institucional, që nënkupton funksionimin e institucionit në përputhje me ligjin, procedurat e brendshme në një mënyrë transparente, të përgjegjshme, efikase dhe etike në mënyrë që të realizohen të drejtat, interesat dhe nevojat e përdoruesve të institucionit dhe atyre që mundësojnë funksionimin e institucionit.
- ▲ Integriteti normativ, që nënkupton zhvillimin e akteve normative në përputhje me nevojat, interesat dhe përparësitë, përkatësisht vlerat në një proces pjesëmarrës që është një konflikt transparent, i rreg-

ulluar i interesave dhe pa vendimmarrje diskrecionale.

- ▲ Integriteti profesional, i cili përfshin pajtueshmërinë e anëtarëve të profesionit me standardet dhe vlerat etike/parimet e profesionit, përkatësisht për të luftuar nëpërmjet një shoqate profesionale dhe me kolegë nga profesioni për të ruajtur dhe promovuar integritetin e profesionit dhe shoqërisë.
- ▲ Integriteti qytetar, që nënkupton gatishmërinë e qytetarëve për të përcaktuar dhe ushtruar të drejtat dhe interesat e tyre në përputhje me ligjet dhe standardet etike, më saktësisht gatishmërinë e qytetarëve për të luftuar vetëm ose në solidaritet për ruajtjen dhe promovimin e të gjitha formave për integritet<sup>3</sup>.

Burimet anti-korrupsion përfshijnë: mjetet materiale dhe teknologjike, ligjet, aktet nënligjore, instrumentet etike të menaxhimit (kodet, statutet, deklaratat), praktikrat, njohuritë, aftësitë dhe personeli. Ato janë të nevojshme, por jo të mjaftueshme, për të luftuar korrupsionin. Ekzistenca e burimeve anti-korrupsion është shpesh një lloj anti-korrupsion i llojit "Potemkinovo Selo", sepse nuk ka rezultate pozitive dhe ndikime në luftën kundër korrupsionit, gjegjësisht përforcimin e integritetit si mjedis në kuptimin e gjerë të fjalës që zvogëlon rrezikun e korrupsionit. Kështu kemi arritur në ndikimin, ose rezultatet në luftën kundër korrupsionit si një variabël në përkufizimin tonë të anti-korrupsionit.

Ndikimi ose rezultati është një ndryshim i vërtetuar shkencërisht në fushën e uljes së korrupsionit, gjegjësisht parandalimin e mundësisë së shfaqjes së korrupsionit, i cili është rezultat i zbatimit të strategjisë, politikës, ligjit, aktiviteteve anti-korrupsion të çdo aktori në fushën e luftës kundër korrupsionit.

<sup>3</sup> Zoran Gavrilović dhe tjerë (2014), Lufta kundër korrupsionit në Serbi – Raporti alternativ, Byroja për Hulumtime Shoqërore, Beograd

Në fund të pjesës hyrëse, është me rëndësi të veçantë të theksohet rëndësia e integritetit në luftën kundër korrupsionit. Kjo do të thotë që krijimi i burimeve anti-korrupsion, aplikimi i tyre, por edhe vlerësimi i aplikimit të tyre duhet të bëhet dhe/ose të realizohet në një mjedis për integritet institucional, normativ, profesional dhe civil. Kjo do të thotë gjithashtu se është një proces në të cilin ka transparencë dhe pjesëmarrje në proces, konflikt i rregulluar i interesave, akumulim i parandaluar i funksioneve, vendimmarrje e rregulluar diskreionale dhe mbrojtje e informatorëve.

Të gjitha faktet më sipër paraqesin një zbatim i parimit për integritet anti-korrupsion:

- ▲ **Dimenzioni zhvillimor** - zbatimi i luftës kundër korrupsionit kryhet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe të drejtat e njeriut dhe është në funksion të zhvillimit demokratik të shoqërisë, tregut të lirë, sundimit të ligjit dhe përfshirjes sociale;
- ▲ **Inovacioni** - në luftën kundër korrupsionit, do të kërkohen modele inovative dhe të qëndrueshme anti-korrupsion bazuar në arritjet shkencore dhe praktikrat e provuara;
- ▲ **Pjesëmarrja** - të gjithë aktorët relevantë në sektorin publik, privat dhe shoqërinë civile duhet të përfshihen në mënyrë efektive në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të luftës kundër korrupsionit;
- ▲ **Transferimi i njohurive** - pjesëmarrësit në luftën kundër korrupsionit do të sigurohen që njohuritë dhe përvoja e tyre të jenë në dispozicion për çdo person që kërkon një njohuri dhe/ose përvojë të tillë, veçanërisht nëse shteti tregon interes për atë;
- ▲ **Matshmëria** - për të siguruar monitorimin e luftës kundër korrupsionit në një mënyrë që respekton parimet epistemologjike: objektiviteti, përgjithësia, saktësia, verifikueshmëria;
- ▲ **Motivimi** - të sigurojë mekanizma efektive për shpërblimin dhe sanksionimin e pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të politikave anti-korrupsion;
- ▲ **Integriteti** - organet kompetente për luftën kundër korrupsionit, si

dhe punonjësit e tyre, gjegjësisht të gjithë ata që do të përcaktohen për luftë kundër korrupsionit, sjellja e tyre nuk duhet të rrezikojë besimin në luftën kundër korrupsionit ose të fitojë ndonjë përfitim personal që nuk është në përputhje me ligjin ose parimet etike të profesionit të cilit ata i përkasin. Aktivistët kundër korrupsionit duhet të veprojnë pa interes dhe në përputhje me procedurat e paracaktuara të zgjedhjes së çështjeve që do të hetohen në mënyrë që të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për viktimat e korrupsionit. Në këtë mënyrë, do të krijohet besimi se të gjithë ata që janë viktimat të korrupsionit trajtohen dhe mbështeten në mënyrë të barabartë, gjegjësisht që ata nuk janë të diskriminuar në asnjë mënyrë;

- ▲ **Kumulativiteti** - të gjithë mekanizmat ekzistues anti-korrupsion do të vlerësohen në një mënyrë objektive, profesionale dhe të pavarur, dhe përvojat dhe praktikatat e verifikuara do të vazhdojnë të përdoren;
- ▲ **Qasja multisektoriale** - të gjithë sektorët e shoqërisë kanë përgjegjësi të barabartë në luftën kundër korrupsionit, sepse lufta kundër korrupsionit në vetëm një ose më shumë sektorë nuk është një garanci për një luftë të qëndrueshme kundër korrupsionit në një shoqëri me korrupsion sistematik;
- ▲ **Zbatueshmëria** - çdo strategji, politikë ose masë anti-korrupsion duhet të ketë burimet dhe kompetencat e nevojshme për të zbatuar mekanizmat e sanksioneve për mosrespektimin dhe/ose mungesën e rezultateve në luftën kundër korrupsionit.

Në pjesën hyrëse, ne prezantuar kornizën konceptuale dhe teorike, të cilën do të përdorim në vazhdim të prezantimit tonë. Pas prezantimit të këndvështrimit të koncepteve kryesore: institucioni, integriteti, anti-korrupsioni dhe korrupsioni, të cilat kemi dashur të prezantojmë lexuesin në narrativë, në pjesën tjetër të doracaktut do të përqendrohemi në temën kryesore të publikimit, gjegjësisht, cilat janë planet për integritet në prokurimin publik.

## Prokurimi publik dhe mekanizmat për forcimin e integritetit

**P**ara se të kalojmë në fazën tjetër, është e rëndësishme të theksojmë se kur flasim ose punojmë për integritetin e cilitdo segment të shoqërisë, ne punojmë për integritetin e shoqërisë si një e tërë. Megjithatë, integriteti në përgjithësi, dhe kështu integriteti i prokurimit publik, mund të trajtohet në dy mënyra.

Niveli i parë është reduksionist. Fokusi i kësaj qasjeje ndaj integritetit është institucioni që organizon prokurimin publik - autoriteti kontraktues, gjegjësisht procesi i kryerjes së prokurimit publik. Nëse vështrohet në këtë mënyrë, prokurimi publik është një grup aktivitesh dhe kompetencash të ndërlidhura në nivelin e institucionit brenda të cilit:

- ▲ Personat e autorizuar për kryerjen e prokurimit publik (integriteti profesional),
- ▲ Në përputhje me procedurën (integriteti normativ),
- ▲ Ata që vendosin mbi prokurimin e mallrave dhe shërbimeve publike (integriteti institucional),
- ▲ Në përputhje me të drejtat dhe nevojat e përdoruesve të shërbimeve dhe mallrave, qytetarët nga paratë e të cilëve blihen mallra dhe shërbime publike dhe që kanë të drejtën e informacionit, mbikëqyrjes dhe kontrollit (integriteti qytetar).

Nga përkufizimi i mësipërm, procesi i prokurimit publik ndikohet nga katër llojet e integritetit. Ndikimi arrihet nëpërmjet masave të përfshira në planin e integritetit të prokurimit publik. Në këtë mënyrë, zbatimi i planit për integritet të prokurimit publik ka një ndikim të dyfishtë mbi integritetin.

Në fakt, nga njëra anë, kjo ndikon në integritetin e procesit të prokurimit publik dhe mund të quajmë atë një ndikim të drejtpërdrejtë. Lloji i dytë i ndikimit është një ndikim indirekt dhe manifestohet nëpërmjet ndikimit në integritetin e të gjithë institucionit. Integriteti i procesit të prokurimit publik nuk është i izoluar nga pjesa tjetër e institucionit. Ajo është pjesë e integritetit të institucionit, i cili krijon një ndikim indirekt të planit për integritet të prokurimit publik mbi institucionin.

Secila fazë në procesin e prokurimit publik sipas procedurës ka rrezikun e vet për sa i përket prishjes së integritetit, gjegjësisht nevojën për të parandaluar ose rregulluar rrezikun, i cili përforcon integritetin e një prokurimi të veçantë publik.

### Skema e përcaktimeve për integritet në nivelin e proceseve të prokurimit publik:

	Faza e para tenderimit	Faza e tenderimit	Faza e pas tenderimit	
<b>Nevoja dhe të drejta të institucioneve dhe qytetarëve si klientë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Akt i brendshëm dhe kontroll të prokurimeve, shpërndarja e përgjegjësi, organizimi dhe komunikimi</li> <li>- Akt i brendshëm për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave</li> <li>-Mbrojtja e të dhënave, dokumentimit dhe evidentim të procedurës</li> <li>-Komunikim i brendshëm mes sektorëve – departamenti për prokurime publike, departamenti për buxhet, kontrolli i brendshëm dhe sektorët individual</li> <li>-Vlerësim i nevojave reale, vlerësim i mjeteve në dispozicion, zgjedhje të procedurave, shpenzimeve për ciklin e jetës</li> <li>-Plan për prokurime publike, vlerësim të planit, ndryshime dhe plotësime të planit, revizion të planit</li> <li>- Plan për prokurime që nuk është i lidhur me LPP (nën pragun edhe i injoruar nga LPP për shkaqe speciale)</li> <li>- Publikimi i të dhënave</li> <li>- Vlerësim të vlerës së procedurave</li> <li>- Hulumtim të tregut, komunikim me aktorët në treg</li> <li>- Përgatitja dhe përpunimi i analizave eksperte</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- formimi i Komisionit për Prokurime Publike, miratim të vendimit për fillim të procedurës</li> <li>-Përgatitje të dokumenteve të tenderimit (faza para vetë publikimit), specifikimi teknik, kriteret për zgjedhje dhe kriteret për aprovim, kontratë, modele</li> <li>-Publikimi i shpalljes dhe dokumentimit të tenderimit</li> <li>-Komunikimi me palët e interesuara, pyetje dhe përgjigje, ndryshime dhe plotësime të dokumentimi të tenderimit dhe afateve</li> <li>-Pranim i ofertave</li> <li>-Hapje të ofertave</li> <li>-Vlerësimi ekspert i ofertave dhe pyetjeve plotësuese për operatorët ekonomik</li> <li>-Vendim për dhënien e kontratës</li> <li>-Mbrojtje të drejtave të pjesëmarrësve në procedurën</li> <li>-Nënshkrimi i kontratës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporte për realizim të kontratës</li> <li>- Ndryshime dhe plotësime të kontratës</li> <li>- Vlerësim të zbatimit, mbikëqyrjes, kontrollit</li> <li>- Rezultati i prokurimit publik të zbatuar</li> <li>- Kontrolli i brendshëm</li> <li>- Vlerësimi</li> <li>- Trajnim dhe mirëmbajtja e nivelit të njohurisë së punonjësve</li> <li>- Integritet dhe etikë të procedurës</li> </ul>	<b>Cilësi e mallit dhe shërbimeve në aspekt të përdoruesit dhe profesionit</b>
	Integriteti institucional – integriteti normativ – integriteti profesional – integriteti qytetar			
	Integriteti i institucionit			



Themeluesi i planeve për integritet në zonat e Sllavëve të Jugut është Komisioni Slloven për Parandalimin e Korrupsionit, i cili ndau praktikën me organet anti-korrupsion të vendeve në rajonin e ish-Jugosllavisë<sup>4</sup>.

Rezultati nga kjo është, ndër të tjera, zhvillimi i një plani të brendshëm për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, i cili parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik në Serbi<sup>5</sup>. Ky instrument anti-korrupsion rregullon në mënyrë më të detajuar ndërmarrjen e të gjitha masave dhe aktiviteteve të nevojshme për të parandaluar korrupsionin në planifikim, në procedurën e prokurimit publik ose gjatë ekzekutimit të kontratave të prokurimit publik. Plani i brendshëm synon të identifikojë rreziqet për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit dhe parregullsive të tjera në prokurimin publik me autoritetin kontraktues, dhe pastaj të eliminojë dhe zvogëlojë këto rreziqe duke marrë masat e nevojshme parandaluese (miratimi i procedurave, duke vepruar në përputhje me ato).

Duke u bazuar në konceptin “Foleja e integritetit”<sup>6</sup>, i zhvilluar nga dega Australiane e Transparencës Ndërkombëtare, për qëllimet e këtij doracaku kemi zhvilluar një qasje të gjithanshme për integritetin e prokurimit publik në formën e një “Koncepti për integritet të Prokurimit Publik”.

Për dallim nga qasja reduksioniste, e cila trajton integritetin e prokurimit publik (niveli i procesit) dhe integritetin e institucionit (niveli institucional), koncepti holistik “Fusha e integritetit të prokurimit publik” merret me integritetin e të gjithë aktorëve relevantë të përfshirë në procesin e prokurimit publik (qasja sistematike).

<sup>4</sup> Sipas gjetjeve të Nemanja Nenadiq, nga organizata Transparencë Serbi, në iniciativë të Këshillit të Evropës dhe Misionit të OSBE në Serbi (në atë kohë, edhe të Malit të Zi), Strategjia Kombëtare për Luftë kundër Korrupsionit në Republikën e Serbisë në vitin 2005 ka përfshirë obligim për përgatitjen e planeve për integritet sipas modelit të zhvilluar nga komisioni sllovak për parandalimin e korrupsionit.

<https://www.kpk-rs.si/preventiva-in-integriteta/nacr-integritete/>  
Burim: <https://www.uts.org.rs/images/integritet.pdf> (faqe 20)

<sup>5</sup> <https://www.paragraf.rs/propisi/zakon-o-javnim-nabavkama.html>

<sup>6</sup> <https://core.ac.uk/reader/143860850>

Prokurimi publik nuk është një proces më vete, por një proces ku zhvillohen aktivitete që janë pjesë ose produkt i aktorëve të ndryshëm, gjegjësisht, interesat, integriteti dhe potencialet korruptive jashtë institucionit që zbaton prokurimin publik, por edhe korniza normative që ndikon indirekt në integritetin e prokurimit publik.

Avantazhi i qasjes holistike pasqyrohet në faktin që përfshin pjesëmarrës nga të gjithë sektorët (publik, civil dhe privat). Kjo krijon një mekanizëm anti-korrupsion jo vetëm në sektorin publik, i cili nuk është sektori i vetëm në të cilin ekziston korrupsioni.

Me rëndësi është të theksohet që Rekomandimet e OECD<sup>7</sup> mbi Avancimin e Integritetit në Prokurimin Publik, të cilat përshkruajnë aktorët dhe proceset që kanë të bëjnë me kuptimin holistik të planit për integritet të prokurimit publik, mbështesin argumentin për rëndësinë e konceptit “Fusha e Integritetit të Prokurimit Publik”. Rekomandimet janë të ndarë në fusha:

### Transparenca

- ▲ Të sigurohet një shkallë adekuate të transparencës gjatë gjithë ciklit të prokurimit në mënyrë që të promovohet një trajtim të drejtë dhe reciprok të furnizuesve të mundshëm
- ▲ Transparenca maksimale në ankandet konkurruese dhe në veçanti marrja e masave parandaluese për të përmirësuar integritetin e përjashtimeve nga ankandet konkurruese

### Qeverisje e mirë

- ▲ Të sigurohet që fondet publike të përdoren në prokurimin publik ashtu siç synohet
- ▲ Të sigurohet që zyrtarët e prokurimit përmbushin standarde të larta profesionale të njohurive, aftësive dhe integritetit

<sup>7</sup> <https://www.oecd.org/gov/ethics/48994520.pdf>

## Parandalimi i sjelljes së keqe, respektimi dhe mbikëqyrja

- ▲ Të krijohen mekanizma për të parandaluar rrezikun ndaj integritetit të prokurimit publik
- ▲ Të inkurajohet bashkëpunim i ngushtë mes qeverisë dhe sektorit privat për të ruajtur standarde të larta për integritet, veçanërisht në menaxhimin e kontratave
- ▲ Të sigurohen mekanizma të veçantë për monitorimin e prokurimit publik, si dhe për zbulimin e sjelljes së pahijshme dhe zbatimin e dukur të sanksioneve

## Përgjegjësi dhe kontroll

- ▲ Të vendoset një zinxhir të qartë të përgjegjësisë së bashku me mekanizmat efektivë të kontrollit
- ▲ Të përpunohen ankesat nga furnizuesit e mundshëm me ndershmëri dhe në kohën e duhur
- ▲ Zgjidhja e drejtë dhe në kohë e ankesave nga furnizuesit e mundshëm.
- ▲ Të përforcohen organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe publiku i gjerë për të kontrolluar prokurimin publik.

Gjithçka e shkruar më sipër flet për nevojën e zbatimit të një qasjeje holistike të mishëruar në "Fushën e Integritetit të Prokurimit Publik", sipas të cilit planet për integritet të prokurimit publik kontribuojnë në integritetin e shoqërisë, pavarësisht nga sektori.

Si mbështetje e kësaj më lartë flet edhe fakti që fusha e integritetit të prokurimit publik e përbëjnë, përveç institucionit që organizon prokurimin publik, dhe atyre që kujdesen për zbatimin e ligjit dhe sanksionimin e rasteve të shkeljeve të mundshme, aktorët publikë pjesë e të cilave janë mediat, por gjithashtu edhe qytetarët si financues dhe përdorues të shërbimeve për të cilat prokurohen mallra dhe shërbime:

- ▲ Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
- ▲ Enti Shtetëror i Revizionit
- ▲ Byroja e Prokurimit Publik
- ▲ Komisioni Shtetëror për Ankesat e Prokurimit Publik
- ▲ Prokuroria Publike
- ▲ Gjykata
- ▲ Autoriteti kontraktues
- ▲ Shërbimi i Prokurimit Publik nga një autoritet kontraktues
- ▲ Operatorët ekonomik
- ▲ Punonjësit e autoritetit kontraktues
- ▲ Punonjësit e operatorit ekonomik
- ▲ Sindikata pranë një autoriteti kontraktues
- ▲ Shoqatat profesionale të profesionit që punojnë në prokurimin publik
- ▲ Qytetarët
- ▲ Mediat
- ▲ Shoqëria civile

Nga këndvështrimi i konceptit “Fusha e integritetit të prokurimit publik”, plani i integritetit të prokurimit publik ka për detyrë të hartojë dhe zvogëlojë, gjegjësisht të eliminojë rreziqet për integritetin brenda prokurimit publik me anë të:

- ▲ Zbatimi i ekspertizës nga ekspertët në fushat që janë të rëndësishme për kryerjen e prokurimit publik në përputhje me rregullat e profesionit dhe pajtueshmërinë me kodin e profesioneve;
- ▲ Veprimi ligjor, respektimi i parimeve të transparencës, rregullimi i konfliktit të interesit dhe vendimmarrja diskrecionale, ekzistenca dhe respektimi i kriterëve të qarta për vendimmarrje në procesin e prokurimit publik;
- ▲ Planifikimi dhe vendimmarrja dhe zbatimi i kontratave të prokurimit publik për mallra dhe shërbime me të vërtetë të nevojshme;
- ▲ Ekzistenca e mundësive, interesit dhe informimit të qytetarëve, përkatësisht përdoruesve për të marrë pjesë në procesin e planifikimit dhe zbatimit të prokurimeve publike.

Të gjitha më sipër duhet të zbatohen në një mënyrë ekonomike dhe efikase që siguron konkurrencën në kushte të pozitës së barabartë të gjitha njësisve ekonomike pa diskriminim dhe në kushte transparente.

Mungesa e njërit prej këtyre katër llojeve për integritet në procesin e prokurimit publik mund të jetë burim i rrezikut për integritetin e prokurimit publik. Si pasojë, ekziston rreziku që prokurimi publik të mos përmbushë funksionin e përcaktuar me ligj, dhe ajo është prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me fonde publike në dispozicion dhe në përputhje me nevojat e autoritetit kontraktues, dhe është në interes dhe në përputhje me të drejtat e përdoruesve të mënyrës ekonomike, transparente dhe efikase në kushtet e konkurrencës, ku ka qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa diskriminim për asnjërin prej tyre, si nga autoriteti kontraktues dhe nga autoritetet shtetërore kompetente, dhe nga palët e interesuara (autoritetet e interesuara).

Në kontekstin e prokurimit publik, integriteti institucional nënkupton pajtueshmërinë me ligjet, procedurat dhe standardet profesionale që janë në përputhje me interesat e autoritetit kontraktues si institucion

në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe jo me nevojat personale. Prandaj, zbatimi i prokurimit publik është një proces që përcakton integritetin e të gjithë institucionit.

Një lidhje e rëndësishme si në integritetin e institucionit ashtu edhe në integritetin e prokurimit publik është integriteti profesional. Kjo përfshin aderimin e anëtarëve të profesionit në standardet e profesionit dhe vlerat/parimet etike të profesionit. Kur bëhet fjalë për prokurimin publik, të gjithë personat e përfshirë në procesin e planifikimit, kryerjes së prokurimit publik dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave të prokurimit publik me integritetin e tyre profesional kontribuojnë në integritetin e prokurimit publik.

Në fakt, secili profesion ose anëtar ka ekspertizë - monopol mbi njohuritë dhe/ose aftësitë e caktuara. Personat e përfshirë në procesin e prokurimit publik, me një monopol mbi njohuritë, zbatojnë ekspertiza (interpretajnë ligjet ose kryejnë analiza) që çojnë në rezultate që ndikojnë në ligjshmërinë e procesit të prokurimit publik, gjegjësisht në cilësinë e shërbimeve ose mallrave të blera me anë të prokurimit publik.

Përveç dimensionit personal për integritet profesional, respektimi i etikës profesionale dhe rregullave të profesionit duhet të kujdeset nga një shoqatë profesionale që lufton për të ruajtur dhe përmirësuar integritetin e profesionit dhe shoqërisë.

Si pasojë e mungesës së integritetit normativ në prokurimin publik, ka shkelje të ligjshmërisë dhe transparencës, gjegjësisht ekziston vendimmarrje diskrecionale në nivelin e procedurës dhe mos-rregullim i konfliktit të interesit. Kjo rezulton në sasi dhe cilësi të reduktuar të ofertave në prokurimin publik, dhe kështu cilësi më të ulët dhe çmim më të lartë për mallrat dhe shërbimet.

Integriteti qytetar i mishëruar në gatishmërinë e qytetarëve për të përcaktuar dhe ushtruar të drejtat dhe interesat e tyre në përputhje me ligjet dhe standardet etike, gjegjësisht gatishmëria e qytetarëve për të luftuar vetëm ose në solidaritet për të ruajtur dhe promovuar të gjitha format e integritetit është një faktor që ndikon në integriteti i prokurimit publik. Kjo veçanërisht u referohet atyre pjesëve të prokurimit publik që nuk janë të rregulluara ligjërisht, gjegjësisht i japin mundësinë qytetarit të tregojë veprimet e paligjshme ose joetike që çuan në shërbime të

papërshtatshme ose mallra të marra nga qytetarët - përdoruesit me anë të prokurimit publik.

Analiza e integritetit në prokurimin publik nga aspekti i "Fushave për integritet në prokurimin publik" ka dy nivele të prokurimit publik.

E para i referohet vetë fushës, gjegjësisht procesit të prokurimit publik të definuar nga procedurat e përcaktuara nga ligji që rregullon prokurimin publik.

E dyta i referohet zhvillimit dhe zbatimit të akteve strategjike dhe normative që rregullojnë drejtpërdrejt fushën e prokurimit publik (revizioni publik, konflikti i interesit, pozicioni i tregut, qasja e lirë në informacion, mbrojtja e informatorëve) në fushën e monitorimit dhe vlerësimit, kontrollin, përkatësisht mbështetjen dhe ndëshkimet në rast të shkeljes së ligjit.

## Përgatitja e planit për integritet

**P**lanet për integritet janë një instrument i qeverisjes etike që synon të ndërtojë aftësinë e institucionit për të mbrojtur veten ndaj rreziqeve të hartuara më parë saktësisht dhe potencialisht të mundshëm të korrupsionit që do të ndikojnë në kryerjen e funksionit të caktuar nga shoqëria dhe shteti, gjë që reflektohet në kompetencën përkatëse ligjore.

Për të parandaluar rreziqet e mësipërme, duhen plane për integritet që synojnë krijimin ose përmirësimin e integritetit të procesit të prokurimit publik nëpërmjet të cilit:

- ▲ Identifikohen dobësitë e integritetit në procesin e prokurimit publik,
- ▲ Përcaktohet fusha dhe mënyra e largimit të tyre dhe
- ▲ Specifikohen mjetet e nevojshme për largimin e tyre.

Funksionaliteti i planeve për integritet pasqyrohet në:

- ▲ Përcaktimi i shkallës së rezistencës së institucionit ndaj korrupsionit;
- ▲ Identifikimi i pikave të rrezikut për korrupsion në nivelin e institucionit;
- ▲ Zhvillimi i propozim masave për parandalimin e rreziqeve të korrupsionit, gjegjësisht për eliminimin e tyre nëpërmjet strukturave organizative, procedurave dhe praktikave në nivelin e institucionit;
- ▲ Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planit për integritet.



Plani për integritet synon të:

- ▲ Përmirësojë transparencën e proceseve dhe procedurave të punës
- ▲ Përmirësojë sistemin për mbikëqyrje efikase mbi ekzekutimin e proceseve të punës
- ▲ Zvogëlojë ose rregullojë vendimmarrjen diskreacionale
- ▲ Përmirësojë llogaridhënien
- ▲ Përforcojë zbatimin e sjelljes profesionale

Siç e theksuam në hyrje, planet për integritet mund të bëhen për të gjitha segmentet e shoqërisë. Përveç institucioneve të sektorit publik, një plani për integritet duhet të hartohet nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe private. Praktika nga Sllovenia, e cila filloi së pari me zhvillimin dhe zbatimin e planeve për integritet (më vonë Serbia, Bosnja dhe Hercegovina deri në Malin e Zi) është e tillë që institucioneve publike, përkatësisht përdoruesve të buxhetit u kërkohet me ligj të hartojnë planin e tyre për integritet, ndërsa institucionet dhe organizatat nga sektori privat dhe jofitimprurës mund të bëjnë këtë sipas gjykimit të tyre.

Modelet e planit për integritet janë krijuar nga organet kombëtare për luftë kundër korrupsionit, gjegjësisht agjencitë që, në bashkëpunim me praktikuesit e ardhshëm të planeve për integritet, kryejnë kërkime të vetë-vlerësimit, hartojnë rrezikun e korrupsionit në nivelin institucional dhe një sërë masash për parandalimin ose eliminimin e rreziqeve të hartëzuara. Përforcimi i integritetit të institucionit zvogëlon rrezikun që kompetencat të ushtrohen në kundërshtim me objektivat për të cilat ato janë krijuar, gjë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së punës së institucionit, dhe kështu rrit besimin e publikut në punën e tyre.

Përmbajtja e planit për integritet varet nga natyra e institucionit, por përmban elementet themelore:

- ▲ Vlerësimi i ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit;
- ▲ Personi i zgjedhur që kujdeset me përgjegjësi për krijimin dhe zbatimin e planit për integritet;
- ▲ Përshkrimi i procesit të punës dhe metodave të vendimmarrjes, duke identifikuar aktivitete me rrezik;
- ▲ Përcaktimi i masave parandaluese për të zvogëluar mundësinë e korrupsionit.

Praktika aktuale është që plani për integritet u krijua si rezultat i vetëvlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, si dhe ekspozimit ndaj procedurave etike dhe profesionale të papranueshme.

Duke pasur parasysh që integriteti i një institucioni, gjegjësisht. Një proces i tillë si prokurimi publik varet nga përshtypja e profesionalizmit, ndërgjegjshmërisë, paanësisë, pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret të tjera, kjo lloj eksperience subjektive e integritetit është po aq e rëndësishme sa një pjesë e integritetit të institucioni ose procesi gjendja e të cilit është identifikuar gjatë zhvillimit të planit për integritet bazuar në vetëvlerësimin.

Për atë arsye, është e rëndësishme të zhvillohet dhe azhurnohet procesi i zhvillimit të një plani për integritet, gjegjësisht, të zbatohet një qasje holistike për zhvillimin e planeve për integritet që këmbëngul në lidhjen e këtyre dy pikëpamjeve.

E para është që i referohet përcaktimit në çfarë mase dhe në çfarë mënyre realizohen interesat, nevojat dhe të drejtat, gjegjësisht, si jo vetëm anëtarët e institucionit dhe klientët e institucionit e shohin integritetin, por edhe profesionin, trupat dhe të ngjashme.

Pikëpamja e dytë përfshin informacionin se si anëtarët e institucionit dhe klientët e tij e shohin karakterin e strukturës së institucionit për të cilin po përgatitet plani i integritetit, në këtë rast plani i integritetit të prokurimit publik, i cili përbëhet nga:

- ▲ Sistemi i vlerës (orientimet e vlerës),
- ▲ Sistemi normativ (normat),
- ▲ Sistemi organizativ (statusi dhe rolet),
- ▲ Sistemi i personelit (kuadrot -aktorët),
- ▲ Sistemi i komunikimit (informacioni),
- ▲ Mjedisi (të drejtat dhe detyrimet e klientëve dhe mjedisi superior).

Sipas kësaj metodologjie, procesi i hartimit të planit zhvillohet në tre faza.

Në fazën e parë njoftohen, gjegjësisht, të gjithë punonjësit informohen për përgatitjen e planit për integritet. Në këtë fazë, udhëheqësi i institucionit merr një vendim për të caktuar një grup pune për zhvillimin e planit për integritet (në tekstin e më tutjeshëm: Grupi i Punës). Grupi i punës ka koordinatorin e vet dhe një numër të tek të anëtarëve, duke marrë parasysh që secili segment, përkatësisht njësia organizative e institucionit ka përfaqësuesin e vet.

Në fazën e dytë, vlerësohet gjendja aktuale e integritetit:

- ▲ Duke analizuar masat ekzistuese të menaxhimit të rrezikut
- ▲ Duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit.

Për nevojat e vlerësimit të situatës aktuale, përdoret një pyetësor i cili plotësohet nga të gjithë punonjësit në institucion, gjegjësisht analiza juridike, sociologjike, ekonomike e procedurave të kryera nga anëtarët e Grupit të Punës.

Në fazën e tretë, përfundimtare, janë planifikuar masa për të përmirësuar integritetin e institucionit. Si rezultat, kemi një plan integriteti që përfshin:

- ▲ Personi përgjegjës,
- ▲ Afatet,

- ▲ Vlerësimet: “masa është zbatuar” ose “masa nuk është zbatuar” (matet vetëm realizimi, por jo efekti).

Siç e theksuam në pjesën hyrëse, integriteti zero ka një rëndësi të veçantë në hartimin dhe zbatimin e mekanizmave anti-korrupsion. Në këtë rast, kjo do të thotë që gjatë krijimit të planit për integritet, është shumë e rëndësishme të kushtoni vëmendje të dy dimensioneve të zhvillimit të një plani për integritet. Në fakt, ato janë:

- ▲ Integriteti i procesit të zhvillimit të një plani integriteti,
- ▲ Rëndësia profesionale në përgatitjen e planit për integritet<sup>8</sup>.

Integriteti i zhvillimit të planit për integritet përfshin:

- ▣ Parandalimi dhe rregullimi i konfliktit të interesit në nivelin e Grupit të Punës dhe personit të autorizuar,
- ▣ Parandalimi dhe rregullimi i kompetencave diskrecionare në nivelin e Grupit të Punës dhe personit të autorizuar,
- ▣ Transparenca e procesit të zhvillimit të planit për integritet,
- ▣ Pjesëmarrja në përgatitjen e planit për integritet,
- ▣ Efektiviteti (mungesa/prania e rezultateve në nivelin e ndryshimit të dëshiruar) dhe
- ▣ Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të planit për integritet

<sup>8</sup> Gavrilović Zoran dhe Milutinović Jelena (2014), Analiza e zhvillimit të planeve për integritet et gjykatave në Serbi, Shoqata e Gjykatësve në Serbi, Beograd <http://www.birodi.rs/wp-content/uploads/2014/12/Analiza-izrade-planova-integriteta-u-sudovima-Srbije.pdf>

Nga ana tjetër, rëndësia profesionale në përgatitjen e planit për integritet përfshin:

- ▣ Respektimi i parimeve epistemologjike (objektiviteti, sistematizimi, përgjithësia ...) gjatë mbledhjes, analizimit dhe përpunimit/interpretimit i të dhënave mbi bazën e të cilave përcaktohen rreziqet e integritetit. Kjo kryesisht i referohet kryerjes së një studimi për të identifikuar planet për integritet
- ▣ Zbatimi i njohurive teorike dhe praktike në fushën e analizës të trajtuara nga plani i integritetit.

Rëndësia profesionale e përgatitjes së planeve për integritet të prokurimit publik mund të shihet më së miri në përcaktimin nëse disa nga aktorët në procesin e prokurimit publik do të shkojnë në rrugën e korrupsionit ose integritetit.

## Metodologjia për përgatitjen e planit për integritet në prokurimin publik

**N**ë këtë pjesë të doracakut do të paraqesim elementet e planit për integritet të prokurimit publik në dy nivele.

E para është reduksioniste dhe e dyta është holistike. Në këtë mënyrë, institucionet, si dhe publiku, do të jenë në gjendje të zgjedhin qasjen që ata do të përdorin në hartimin e planit për integritet të prokurimit publik. Për secilin nga elementët e planit për integritet të prokurimit publik, lexuesve do t'u paraqitet një zgjidhje brenda një qasjeje reduksioniste dhe holistike, atje ku ka një ndryshim.

### Paraqitja tabelore e qasjes reduksioniste dhe holistike në përgatitjen e një plani për integritet të prokurimit publik

Element në përgatitjen e planit për integritet në prokurimin publik	Qasja reduksioniste	Qasja holistike
Vendim për përgatitjen e një plani për integritet të prokurimit publik	Vendimi merret nga një person i autorizuar (drejtori, menaxheri...)	Vendimi merret nga një organ menaxhues ose mbikëqyrës
Menaxheri i procesit	Një koordinator i grupit të punës emërohet nga një person i autorizuar	Koordinatori i Grupit të Punës për përgatitjen e një plani për integritetin në prokurimin publik të zgjedhur nga anëtarët e këtij organi. Administrimi i procesit, pa të drejtë të vendosjes, drejtohet nga një administrator i caktuar nga një person i autorizuar

Përbërja e Grupit të Punës për zhvillimin e një plani për integritet të prokurimit publik	Të emëruar nga një person përgjegjës	Të përzgjedhur në procesin zgjedhor bazuar në kriteret publike nga radhët e aktorëve relevantë brenda dhe jashtë autoriteteve kontraktuese si një institucion i bazuar në konceptin e integritetit në prokurimin publik
Rregullimi i integritetit të anëtarëve të Grupit të Punës për Zhvillimin e një Plani për integritet të Prokurimit Publik	Anëtarët nënshkruajnë një deklaratë për integritet	Anëtarët nënshkruajnë një deklaratë për integritet
Metodologjia e hartës së rrezikut	Vetëvlerësimi i rrezikut nga aktorët në autoritetet kontraktuese si institucion	Vlerësimi i rrezikut nga të gjithë palët e interesuara me kompetenca dhe interesa brenda dhe jashtë autoriteteve kontraktuese si një institucion i bazuar në konceptin në fushën e integritetit të prokurimit publik
Përbajtja e përgatitjes së një plani për integritet të prokurimit publik	Rreziqet dhe masat në nivelin e autoritetit kontraktues	Rreziqet dhe masat në nivelin e prokurimit si institucione dhe në lidhje me aktorët brenda "Fushës së integritetit të prokurimit publik"
Mbikëqyrja e aplikimit	Koordinatori i grupit të punës i emëruar nga një person i autorizuar	Personi i ngarkuar me mbikëqyrjen zgjidhet jashtë institucionit nga një komision i përbërë nga punonjës të autoritetit kontraktues
Njoftim	Raporti përmban informacion mbi zbatimin e masave nga plani i integritetit të prokurimit publik	<b>Raporti përmban:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>informacion mbi përm-bushjen e masave nga plani</li> <li>informacion mbi zbatimin dhe nevojën për ndryshime ligjore, nënligjore dhe institucionale</li> </ul>

Hapat në përgatitjen e një plani për integritet të prokurimit publik përbëhen nga:

- ▲ Marrja e vendimit për përgatitjen e planit të prokurimit publik;
- ▲ Marrja e një vendimi për personin përgjegjës për përgatitjen e planit për integritet të prokurimit publik;
- ▲ Marrja e një vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Punës për përgatitjen e planit për integritet të prokurimit publik;
- ▲ Miratimi i Rregullores së punës për punën e Grupit të Punës për përgatitjen e planit për integritet të prokurimit publik;
- ▲ Nënshkrimi i Deklaratës së Integritetit të anëtarëve të Grupit të Punës për përgatitjen e planit për integritet të prokurimit publik;
- ▲ Kryerja e analizës së rrezikut në nivelin e integritetit të prokurimit publik;
- ▲ Marrja e vendimit për pjesën e masave për planin e integritetit të prokurimit publik;
- ▲ Marrja e një vendimi për përzgjedhjen e një personi i cili do të monitorojë zbatimin e planit për integritet të prokurimit publik të autoritetit kontraktues
- ▲ Përgatitja e një raporti mbi zbatimin e planit për integritet të prokurimit publik



### **Miratimi i vendimit për zhvillimin e një plani për integritet të prokurimit publik**

Vendimi për të zhvilluar një plan për integritet të prokurimit publik në përputhje me praktikën e reduktimit merret nga personi përgjegjës.

Alternativa, sipas qasjes holistike, është se ky vendim mund të merret nga organ që administron institucionin ose organ që ka një funksion mbikëqyrës. Marrësi i vendimeve duhet të shpjegojë zgjedhjen kur bëhet fjalë për zgjedhjen e një modeli për t'u përdorur. Në këtë mënyrë, rregullohet një nga rreziqet e mundshme në procesin e hartimit të një plani për integritet të prokurimit publik për autoritetin kontraktues, i cili është vendimmarrja diskrete e vendimmarrësit në fillim të përgatitjes së këtij instrumenti anti-korrupsion . Gjegjësisht, duket se ky është hapi i parë në transparencën e procesit, i cili është në funksion për integritet të tij.

### **Miratimi i vendimit për personin përgjegjës për hartimin e Planit për integritet të Prokurimit Publik**

